



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 4.6.2024

Nr: 11

Ora: 10:45

VENDIM

PËR

PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 7, DATË 29.5.2024 TË DEPOZITUAR NGA SUBJEKTI "BINDJA DEMOKRATIKE"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 4.6.2024, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Partia Bindja Demokratike

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 38, datë 09.04.2024 "Për miratimin e raportit mbi gjetjet nga auditimi i raporteve financiare të partive politike për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin kalendarik 2022", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

BAZË LIGJORE: Nenet 21 pika 1 shkronja "b", 123/1, 124, 129 dhe 130 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

Data: 4.6.2024 Nr: 11
Ora: 10:45



"Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.5.2024 të depozituar nga subjekti 'Bindja Demokratike'"

VËREN:

Subjekti “Bindja Demokratike”, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 7 regj., datë 29.5.2024.

Në mbledhjen e datës 4.6.2024, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 7, i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të Kodit Zgjedhor dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 7, datë 29.5.2024, të paraqitur nga subjekti “Bindja Demokratike”.
2. Kërkesa ankimore do të shqyrtohet bashkërisht me kërkesën ankimore nr. 5 dhe nr. 6, në seancën e datës 11.06.2024, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	Lako	-	Anëtar
Elvis	Çefa	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar